REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PEQIN**

Nr._____.Prot. Peqin, më ___/___/2024

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr.____, Datë ___/___/2024**

**PËR**
**"MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË BASHKISË PEQIN"**

Në mbeshtetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; të Ligjit nr. 8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë;

**PROPOZIM:**

1. Të miratoj Programin e Transparencës të Bashkisë Peqin sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij projekt-vendimi.

2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe administrata e Bashkisë Peqin.

3. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan

**Konceptoi**
**G.Cani**

**KRYETARI I BASHKISË**

**/ Bukurosh MAÇI /**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PEQIN**

# PROGRAMI I TRANSPARENCËS

## 1. HYRJE

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI"), Autoriteti Publik (në vijim "AP") duhet të publikojë Programin e Transparencës (në vijim "PT") të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"). AP duhet të publikoj informacion sipas veprimtarisë së tij funksionale si dhe të rishikoj e përditësoj PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.
Në PT janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të A.P. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit AP duhet të vlerësojë nësë ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.
Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP.
Në programin e transparencës janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, AP duhet të mbajnë parasysh interesin e publikut si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.

## 2. RRETH AUTORITETIT

2.1 Struktura organizative/Organigrama
2.2 Struktura e pagave
2.3 Funksionet dhe detyrat e A.P
2.4 CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
2.5 Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime
2.6 Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP ( Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).

## 3. KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

3.1 Legjislacion ndërkombëtar
3.2 Legjislacion kombëtar
3.3 Akte nënligjore
3.4 Rregullore
3.5 Kodi i sjelljes

3.6 Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit
3.7 Strategji
3.8 Raport vjetor
3.9 Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun

**4. E DREJTA PËR TU INFORMUAR DHE PËR TU ANKUAR**
4.1 Koordinatori / Eliana Beheluli
4.2 E-mail "eliana.beheluli@peqini.gov.al"
4.3 Nr. i gjelbër
4.4 Tel. +355____________
4.5 Faqja e internetit / www.peqini.gov.al
4.6 Adresa zyrtare e-mail/ info@peqini.gov.al
4.7 Adresa: Bashkia Peqin, Bulevardi "Mustafa Gjinishi", Peqin.
4.8 Orari 08. – 16.00
Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri).

**5. Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP**
5.1 Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë (nëse ka të tillë)
5.2 Planet strategjike të punës
5.3 Raporte monitorimi/auditimi (p.sh:KLSH)
5.4 Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së AP

**6. Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP**
6.1 Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
6.2 Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset
6.3 Donacione, sponsorizime
6.4 Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara
Shënim: Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

**7. Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat**
7.1 Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
7.2 Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
7.3 Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
7.4 Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

**8. Shërbimet që ofrohen nga AP**
8.1 Lista e Shërbimeve* që ofron AP, përfshirë tarifat përkatëse (nëse ka)
8.2 formular aplikimi
8.3 afati kohor
8.4 procedurë ankimimi
8.5 standardet për cilësinë e shërbimit
Shënim: Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etje.

**9. Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP**

9.1 Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)
9.2 Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi
9.3 Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve
9.4 Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes
9.5 Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP
9.6 Emër mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike

**10. Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit**

10.1. Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes
10.2 Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

**11. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**

11.1 Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)

**12. Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP**

12.1 Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP
12.2 Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve
12.3 Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
12.4 Procedura e ankimimit
12.5 Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet

**13. Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP**

13.1 Njoftime të ndryshme
13.2 Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil
13.3 Raporte
13.4 Publikime
13.5 Statistika
13.6 Projekte
13.7 Bashkëpunime etj.
Shënim: AP vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që merr më shpesh.

## IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË PEQIN

| Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë | Baza ligjore | Dokumenti/Përmbajtja | Afati kohor për publikim | Mënyra e publikimit | Struktura përgjegjëse |
|---|---|---|---|---|---|
| Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. | Neni 7/1/a/d | Vendimi për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Peqin dhe institucioneve vartëse<br>Organigrama e funksionimit të administratës së Bashkisë Peqin | Menjëherë pas miratimit të aktit nga Kryetari Bashkisë. | Vendoset e plotë ose në link | Koordinatori<br>Sektori i Burimeve Njerëzore |
| Akte ndërkombëtare<br>ligje;<br>akte nënligjore;<br>dokumente politikash;<br>dokumente të tjera. | Neni 7/1/b | Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"<br>Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"<br>Ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"<br>Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"<br>Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" | Pas hyrjes në fuqi të aktit | Vendoset e plotë ose në link | Koordinatori<br>Sektori i IT |
| Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim,<br>adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat<br>e ankimit të vendimit përkatës. | Neni 7/1/c/g | Dokument shpjegues për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim,<br>Formularin-tip për kërkesë për informacion (lidhja 3) adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. | Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Bashkisë Peqin | Vendoset e plotë | Koordinatori |
| Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik,<br>orarin e punës,<br>emrin dhe kontaktet | Neni7/1/ç | Dokument me informacion të detajuar për të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Bashkisë Peqin, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit | Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Bashkisë Peqin | Vendoset e plotë | Koordinatori |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| e koordinatorit për të drejtën e informimit. | | | | | |
| Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve. | Neni 7/1/d | Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". | Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Bashkisë Peqin | Vendoset e plotë ose ne link | Koordinatori |
| Mekanizmat monitorues; raporte auditi; dokumentet me tregues performance | Neni7/1/dh | Mekanizmat monitorues; raporte auditi; dokumentet me tregues performance | Menjëherë pas përfundimit zyrtar të kontrollit të autoritetit auditues | Vendoset e plotë ose ne link | Koordinatori<br>Drejtoria e Finances dhe Buxhetit |
| Buxheti | Neni 7/1/e | VKB "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Peqin" | Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut | Vendoset me link | Koordinatori<br>Drejtoria e Finances dhe Buxhetit |
| Informacion për procedurat e prokurimit. | Neni 7/1/ë | Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"<br>Ligji nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat"<br>Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike;<br>Regjistri i realizimit të prokurimeve publike; | Menjëherë pas miratimit të procedurave nga titullari i entit prokurues - Bashkia Peqin | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori; Njësia e Prokurimeve Publike |
| Shërbimet e autoritetit për publikun. | Neni 7/1/f | Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit | Menjëherë | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori; Drejtoritë sipas shërbimeve që ofrojnë për publikun |
| Paraqitja e mendimeve në | Neni | Dokument shpjegues për mënyrën e paraqitjes së | Menjëherë | Vendoset i plotë ose | Koordinatori |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| hartimin e p/akteve, etj. | 7/1/gj | mendimeve në hartimin e p/akteve, etj. | | me link | |
| Mbajtja e dokumentacionit nga AP | Neni 7/1/h | Dokument shpjegues përmbledhës për mënyrën dhe llojin e dokumentacionit që administron Bashkia Peqin dhe mënyrën e shfrytëzimit të këtij dokumentacioni nga publiku. | Menjëherë | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori;<br>Sektori i Burimeve Njerëzore, protokollit, arkivit<br>Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014. | Neni 7/1/i | Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014 (lidhja 2) | Menjëherë | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori |
| Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh. | Neni 7/1/k | Formularë të ndryshëm aplikimi | Menjëherë | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori |
| Informacione të tjera të dobishme | Neni 7/1/l | Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak<br>Njoftimet e punësimit me të dhëna sipas përcaktimeve të ligjit 152/2013<br>Informacione mbi aktivitetet e Bashkisë | Sipas afateve ligjore të miratimit dhe publikimit të tyre | Vendoset i plotë ose me link | Koordinatori<br>Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Informacionit |